



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipality Kacanik

01 Nr. 60/01-1445/24
Kaçanik, 31.01.2024

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2(d) lidhur me nenet 40.1 dhe 40.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 04 Qershor 2008), të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës Kaçanik, mbledhjen e vet të mbajtur me 31 janar 2024, mori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2024

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani 01 Nr. 60/01-1445/24, më tekstin e mëtejme: Plani Vjetor i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSb) për periudhën Janar-Dhjetor 2024, i hartuar nga KKSb.
2. Plani i Punës si në pikën 1. të këtij Vendimi përmban; pikësnyimet në lidhje më objektivat nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të KKSb, nivelin e realizimit të tyre, dhe numrin e takimeve për gjatë vitit 2024.
3. Plani i Punës së KKSb, është përmbledhur në gjithsej 3 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohet: Zyra e Kryetarit të Komunës (përmes saj njoftohen anëtarët e KKSb), dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosova



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipality of Kacanik

1	Data	12.01.24	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
		01		60/01-1445

PLANI VJETOR I PUNËS PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR PERIU DHËN JANAR-DHIETOR 2024

Komuna i siguron kushte të punës për mbajtje të takimeve të KKSb-së, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë takimeve. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha takimet dhe rekomandimet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, i'u krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në proceset e zbatimeve të rekomandimeve.

Plani vjetor i punës së KKSb-së është dokument i mbështetur në Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshëm dhe Nr. 03/2012 të miratuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për Këshillit komunal për siguri në bashkësi dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore.

Plani vjetor i punës është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të KKSb-së të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshëm dhe Nr. 03/2012 të miratuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për Këshillat komunal për siguri në bashkësi dhe aktet tjera primare dhe sekondare.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2024, ku Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, planifikon t'i mbaj 6, (gjashtë) takime të rregullta, 3 (tri) prej të cilave në (6) gjashtëmuorin e parë dhe 3 (tri) prej të cilave në 6, (gjashtëmuorin) e dytë të vitit 2024, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet e sigurisë në bashkësi që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Kaçanikut.

Plani vjetor i punës së KKSb-së, do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të KKSb-së, duke iu ofruar anëtarëve të KKSb-së këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2024 e që kanë të bëjnë me sigurinë në bashkësi dhe për interesat e qytetarëve.

Përveç këtyre temave të cekura më poshtë, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, do të shqyrtoj dhe analizoj edhe tema apo çështje tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët dhe Komunën së Kaçanikut në lidhje me sigurinë në bashkësi.

**PLANI VJETOR I PUNËS PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024**

Nr.	Muaji	Çështjet që shqyrtohen	Përgatit	Shqyrton 1	Shqyrton 2	Informon	Vërejtje
1.	Shkurt	Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës. Ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave. Trajtimi i qenve endacak.	Koordinatori i KKSBS-së Policia e Kosovës	Anëtarët e propozuar për KKSBS-ës	KKSBS-së	Kuvendin e Komunës	
2.	Prill	Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Kaçanikut. Vetëdijësimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shpërthyer nga lufta. Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese në territorin e Komunës Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike konkretisht trotuareve.	Drejtoria përkatëse për shërbime publike Koordinatori KKSBS-së Policia e Kosovës dhe Drejtoria e Arsimit	Kryetari i Komunës KKSBS-së	KKSBS-së	Kuvendin e Komunës	
3.	Qershor	Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturantet. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalitetet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm. Parapërgatitja dhe vetëdijësimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror. Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave.	Drejtoria përkatëse për shërbime publike Koordinatori i KKSBS-së Policia e Kosovës Anëtarët e KKSBS-së Drejtoria e Arsimit	Kryetari i Komunës KKSBS-së,	KKSBS-së	Kuvendin e Komunës	

4.	Gusht	Trajtimi i mbrojtjeve të pyjeve nga dëmtuesit ilegal Informatë për fillimin e procesit mësimor dhe gëshnja e sigurisë nëpër shkollë. Informatë dhe analizë nga policia për gëshnjen e vjedhjeve dhe sigurisë së përgjithshme. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta.	DBPZHR Drejtoria e Arsimit Policia e Kosovës FSK-ja dhe Drejtoria përkatëse për shërbime publike	Kryetari i Komunës KKSb-së	KKSb-së	Kuvendin e Komunës	
5.	Tetor	Organizimi i fushatave vetëdijesuse përmes aktiviteteve rekreative, kulturore për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndër fetar Siguria në trafik. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje. Informatë nga Drejtoria e shërbimeve publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit.	DKA Përfaqësuesit e organizatave publike dhe private Policia e Kosovës FSK-ja Drejtoria përkatëse për shërbime publike	Kryetari i Komunës KKSb-së DSHPSE, DUPH	KKSb-së	Kuvendin e Komunës	
6.	Dhjetor	Vetëdijësimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike. Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë tonë përdorin substanca narkotike. Masat për parandalimin e lëmshë-kërkesit Përgatitja e planit të veprim për KKSb për vitin 2024.	Anëtarët e KKSb-së Koordinatori i KKSb-së Anëtarët e KKSb-së FSK-ja Policia e Kosovës	Policia KKSb-së	KKSb-së	Kuvendin Komunës	

Përveç këtyre temave Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, do të shqyrtoj edhe tema tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët Policin e Kosovës dhe Komunën e Kaçanikut .

Komuna: Kaçanik

Data: 12.01.24

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

